



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË

**Drejtuar: Operatorit ekonomik "Kombeas" sh.a**

**Adresa: Fshati Prozhme, Rr: "Dod Lleshi", Milot, Lezhe.**

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Procedura e prokurimit: "Kërkesë për Propozim" "Ndërtimi i Trotuarëve në rrugët "Kasem Shima dhe "Skënderbe" Mëzez Kodër".**

**Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-96432-12-03-2018**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: "Ndërtimi i Trotuarëve në rrugët "Kasem Shima dhe "Skënderbe" Mëzez Kodër".**

**Fondi limit: 8,333,333.2** (tetë milion treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë dy) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2018, miratuar me VKB Nr. 132 datë 21.12.2017, "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018".

**Kohëzgjatja e kontratës:** 3 (tre) muaj kalendarik duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 14.12.2018, ora 11:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 49 datë 11.12.2018.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Operatori ekonomik "Kevin Konstruksion" shpk** NUIS K71401004W

Vlera e ofertës = **0** (Zero) lek.

2. **Operatori ekonomik "K-AAV" shpk** NUIS L51506025C

Vlera e ofertës = **6,324,596** (gjashtë milion treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë ) lekë pa TVSH.

### 3. Operatori ekonomik “Kombeas” SH.A

NUIS K88103301J

Vlera e ofertës = **4,855,022** (katër milion e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëzet e dy) lekë pa TVSH.

### 4. Operatori ekonomik “Eurondertimi” shpk

NUIS K02003001O

Vlera e ofertës = **6,019,774.14** (gjashtë milion nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër pikë katërmëdhjetë ) lekë pa TVSH.

### 5. Operatori ekonomik “Neal 86” shpk

NUIS K04814851T

Vlera e ofertës = **6,312,635** (gjashtë milion treqind e dymbëdhjetëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë ) lekë pa TVSH.

#### **Janë skualifikuar operatorët ekonomik të mëposhtëm:**

#### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

##### **1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik ”Kevin” shpk**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 0 (zero) lekë.

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Kevin” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik vetëm Vertetim Xhiro. Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave.

Mungesa e dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik si dhe mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

##### **2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “K-AAV” shpk**

- Operatori ekonomik “K-AAV” shpk nuk plotëson pikën 2, gëmën “a” të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës*” pasi në Licensën NZ.7193/2 nuk përmban kategorinë e kërkuar “N.P -12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)”.
- Operatori ekonomik “K-AAV” shpk nuk plotëson pikën 2.3, gëmën “a” të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën” pasi Për kontratën e realizuar me sektorin privat me objekt:” Ndërtimi I kantierit të shoqërisë K-AAV” nuk është paraqitur faturë për situacionet.
- Operatori ekonomik “K-AAV” shpk nuk plotëson pikën 4, gëmën “a” të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen **Tetor 2017 - Tetor 2018***” pasi nuk ka paraqitur vërtetim për periudhën Tetor 2017-Dhjetor 2017.

- Operatori ekonomik “K-AAV” shpk nuk plotëson pikën 4 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Një punësim mesatar i të paktën 20 (Njëzetë) personave, për periudhën Tetor 2017 - Tetor 2018 të vërtetuar me.....”* pasi në list-pagesa për periudhën e kërkuar nuk rezulton numri i kërkuar i punonjësve.
- Operatori ekonomik “K-AAV” shpk nuk plotëson pikën 6 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku (i vlefshëm), diploma dhe librezë pune dhe të figurojë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.(Në mbështetje të VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/1 Operatorët ekonomik pjesmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme.)”* pasi për mjekun nuk është paraqitur Urdhër Mjeku.
- Operatori ekonomik “K-AAV” shpk nuk plotëson pikën 6 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si më poshtë.....”* pasi për elektrikistin nuk është paraqitur dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik.
- Operatori ekonomik “K-AAV” shpk nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë.....”* pasi për manovratorët nuk janë paraqitur kontratat e punës.
- Operatori ekonomik “K-AAV” shpk nuk plotëson pikën 11 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001-2015 (e vlefshme).(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO). Shënim: Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë në përmbushjen e kriterit të mësipërm do të konsiderojë të vlefshme dhe paraqitjen e Çertifikatës ISO 14001-2004 (e vlefshme)”* pasi nuk ka paraqitur Çertifikatë ISO 14001-2004.
- Operatori ekonomik “K-AAV” shpk nuk plotëson pikën 14 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatë PASS 99-2012 (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO)”* pasi nuk ka paraqitur Çertifikatë PASS 99-2012.
- Operatori ekonomik “K-AAV” shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9).....”* pasi nuk ka deklaruar dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per mjetin e kerkuara: Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 3,5-5 ton.
- Operatori ekonomik “K-AAV” shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9).....”* pasi nuk ka deklaruar dhe paraqitur dokumentacion per mjetin e kerkuar Autobot Uji.
- Operatori ekonomik “K-AAV” shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për*

ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9).....” pasi nuk ka deklaruar dhe paraqitur dokumentacion per mjetin e kerkuar Autovinc.

- Operatori ekonomik “K-AAV” shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9).....” pasi nuk ka deklaruar dhe paraqitur dokumentacion per mjetin e kerkuar pajisje per stampim betoni.
- Operatori ekonomik “K-AAV” shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9).....” pasi nuk ka deklaruar dhe paraqitur dokumentacion per mjetin e kerkuar pajisje per gazogjen.

### 3. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Eurondertimi” shpk

- Operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk nuk ka paraqitur asnjë kontrate pune të ngjashme për të vërtetuar përvojën e suksesshme, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1.
- Operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë/1 (një) punonjës karpentier*” pasi nuk ka paraqitur dokuemntacion për 1 (një) punonjës karpentier, kontrate pune të vlefshme; deshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.
- Referuar Shtojcës 9, Operatori ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobot uji me targa AA 418 UC. Pas verifikimeve të dokumentacionit shoqërues për mjetin e sipërcituar, u konstatua se mjeti rezulton të jetë Autobot uji i montuar = Kamion + Depozitë uji, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, ku ndër të tjera përcaktohet se: “*Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobot uji*”.
- Shoqëria “Eurondertimi 2000” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) kamion me targa AA 654 RX me kapacitet mbajtës 5.4 Ton, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, ku ndër të tjera përcaktohet se: “*Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 7-10 ton*”.
- Gjithashtu shoqëria “Eurondertimi 2000” shpk nuk ka deklaruar në Shtojcën 9 se disponon 1 (një) Rul me kompresor, 1 (një) pajisje për stampim betoni, 1 (një) gazogjen.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk, referuar Shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

### 4. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Neal 86” shpk

- Operatori ekonomik “Neal 86” shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9).....” pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per mjetin e kerkuar matrapik.
- Pasi verifikimit të Shtojcës Nr.10 u konstatua se mjete i deklaruar Autobot uji me targë AA931KM/ACR568 rezultojnë në dokumentacion Tërheqës dhe Gjysëm rimorkio, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15 ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobot uji”.
- Vlera e ofertes se paraqitur nga shoqëria “Neal 86” shpk është 6,312,635 (gjashtë milion treqind e dymbëdhjetëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë ) lekë pa TVSH. Pas konstatimit të gabimit aritmetik, vlera e absolute e korigjimit aritmetik rezulton më e madhe se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. Në mbështetje të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” (i ndryshuar) , Kreu VII, Neni 66, pika 4 oferta e ketij Operatori Ekonomik refuzohet.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Kombeas” sh.a**, me adresë: Fshati Prozhme, Rr: “Dod Lleshi”, Milot, Lezhe, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **4,855,022** (katër milion e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëzet e dy) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë:** 26.12.2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.